

Ministri i Kulturës, Asaf Ademi, në intervistën për Agjencinë e pavarur gazetareske "Makfaks" është përgjigjur për çështjet aktuale nga sfera e kulturës. Ministri Ademi ka paralajmëruar përkrahje të fuqishme për projektet me të cilat kultivohet trashëgimia e përbashkët kulturore, ka premtuar zero tolerancë për keqpërdorimet në kulturë dhe, nëse personalitete të njohura e kanë shkelur ligjin, të njëjtit duhet të përjigjen.

Ademi po ashtu ka potencuar se Ministria e Kulturës bashkëpunon me Prokurorinë dhe Prokurorinë Publike Speciale, dhe në dispozicion e kanë tërë dokumentacionin e duhur. Në këtë intervistë ai ka paralajmëruar se në konkursin e ri për përkrahjen e projekteve, në Ministrinë e Kulturës do të ketë ndryshime në kriteret dhe se do të formohen komisione tërësisht të reja që do të vendosin për projektet e veprimtarive të ndryshme. **Më shumë detale mund të dëgjoni në video-intervistën në vijim.**